



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
Shoqëria Përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK
NIPT L22412014N
Licencë LN-5977-12-2012

Nr. 235/5Prot.
Nr. 235 Regj.

Datë 25.03.2019

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë

Për dijëni Debitorit: Person Fizik "Fredri Hasa", me NIPT K83730003M, me vend të ushtrimit të aktivitetit në: Rruga Nacionale Korçë-Pogradec, banesë private, Pirg.

Për dijëni Kreditorit: Autoriteti i Mediave Audiovizive, me adresë në rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Tiranë.

Pranë shoqërisë përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, sipas kërkesës Nr. 488 Prot., datë 25.01.2019, të kreditorit Autoriteti i Mediave Audiovizive, është regjistruar çështja përmbareimore me nr. 235 Regj, datë 28.01.2019 me palë:

Kreditor: Autoriteti i Mediave Audiovizive
Debitor: Person Fizik "Fredri Hasa"
Objekti: Vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim nr.73, datë 02.08.2017 i AMA-s, lënë në fuqi me vendimin nr. 178, datë 04.09.2017, të AMA-s, për të cilin është dhënë vendimi nr. 1026, datë 05.06.2018, "Për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit".

Unë përmbareuese gjyqësore private Fatjona Duka, pasi u njoha me aktet e dosjes përmbareimore:

KONSTATOVA

Se, kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive me vendimin nr. 20, datë 26.06.2015 ka vendosur:
"1. Të ndëshkojë me sanksion gjobë në masën 1.000.000 (një milion) lekë subjektin person fizik z. Fredri Hasa, të autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Pirg".
2. Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve.....Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet kamata 2% deri në një muaj". Ky vendim i është njoftuar me shkresën nr. 6593, datë 02.08.2017.

Kundër vendimit të sipërcituar Personi Fizik "Fredri Hasa" ka ushtruar ankim administrativ. Autoriteti i Mediave Audiovizive me vendimin nr. 178, datë 04.09.2017 ka vendosur:
"1. Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 73, datë 02.08.2017, të vendosur nga grupi i inspektimit në masën 1.000.000 (një milion) lekë ndaj subjektit personit fizikz. Fredri Hasa, autorizuar për përsëritjen e shërbimeve të programeve audiovizive të të tretëve mbështetur në rretin kabllor për subjektin OSHMA "Tv Pirg". Ky vendim i është njoftuar debitorit me shkresën nr. 2989, datë 15.09.2017.

Debitori Personi Fizik "Fredri Hasa" nuk ka paguar gjobën e vendosur nga kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive. Në këto kushte kreditori i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendim dënim me gjobë nr. 73, datë 02.08.2017 i AMA-s.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë vendimin nr.1026, datë 05.06.2018, "Lëshim urdhër ekzekutimi", ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesës.*

- *Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për aktin administrativ në trajtën e gjobës nr. 73, datë 02.08.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive lënë në fuqi me vendimin nr. 178, datë 04.09.2017, të AMA-s Nr. 20, datë 26.06.2015 të grupit të Inspeksionit të AMA-s për dënimin me gjobë subjektit person fizik z. Fredi Hasa, për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Pirg" në shumën 1.000.000 (një milion) lekë.*

Me anë të kërkesës drejtuar shoqërisë përmbaruese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, kreditori AMA ka kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim me gjobë në shumën 1.000.000 (një milion) lekë si dhe pagesën e kamatëvonesat ligjore lidhur me gjobën e papaguar.

Në bazë të nenit 30, pika 3, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i cili parashikon se: *"...për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 përqind në muaj të masës së gjobës, ..";* nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i cili parashikon se: *"Vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga organi administrativ që ka kompetencën për shqyrtimin përfundimtar të kundërvajtjes në rrugë administrative";*

si dhe nenit 30, pika 1, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i cili parashikon se:

"Gjoha dhe shumata, që duhet të paguhet sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur: a) është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv..."

përlllogaritja e kamatave do të fillojë të llogaritet nga data 26.09.2017. Vlera e kamatave për shumën e gjobës 1.000.000 (një milion) lekë, përlllogaritet në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë në muaj. Për muajt me 31 ditë, vlera ditore e kamatës është 645 (gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë, ndërsa për muajt me 30 ditë vlera ditore e kamatës është 666 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

Nga data 26.09.2017 dhe deri ditën e nxjerrjes së këtij lajmërimi për ekzekutim vullnetar (28.01.2019) debitori detyrohet të paguajë kamatë në shumën 321.395 (treqind e njëzet e një mijë e treqind e nëntëdhjetë pesë) lekë. Debitori do të detyrohet gjithashtu të paguajë tarifë përmbarimore dhe për vlerën totale të kamatave që do të paguajë në favor të kreditorit. Vlera e kësaj tarife do të përlllogaritet në total për të gjithë kamatat që do të paguhet në favor të kreditorit AMA.

Me shkresën nr. 235/1 prot, datë 28.01.2019, "Lajmërim për ekzekutim vullnetar", në zbatim të nenit 517 të K.Pr.Civile i është komunikuar palës debitore Personit Fizik "Fredi Hasa" me NIPT K83730003M, "Lajmërimi për ekzekutim vullnetar" të detyrimit. Pala debitore Personi Fizik "Fredi Hasa", edhe pas marrjes së këtij njoftimi, nuk ka kryer asnjë veprim për ekzekutimin vullnetarisht të titullit ekzekutiv.

Në kuptim të nenit 2, pika 6, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i cili parashikon se:

"Tregtari, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara, përgjigjet personalisht, me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij të tashme e të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, pronësinë industriale e intelektuale, kreditë ndaj të tretëve e çdo të drejtë apo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para",

sekuestro do të shtrihet jo vetëm në llogaritë, pasuritë dhe kreditë e personit fizik "Fredi Hasa", por edhe në llogaritë, pasuritë dhe kreditë e vetë individit Fredi Hasa, i datëlindjes 15.07.1977, me numër personal H902080300.

Në këto kushte në bazë të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile. vendosa të filloj procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të titullin ekzekutiv për të cilin është dhënë vendimi nr. 1026, datë 05.06.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit",

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të neneve 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat” ;

URDHËROJ

1 Vënien e sekuestros në aktivet e palës debitore Personi Fizik “Fredri Hasa” me NIPT K83730003M.

2. Vënien e sekuestros në kuotat ose aksionet që Personi Fizik “Fredri Hasa” me Nipt K83730003M ose individi Fredri Hasa, i datëlindjes 15.07.1977, me numër personal H902080300, mund të zotërojë në shoqëri të tjera, në cilësinë e ortakut ose aksionarit.


3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.

4. Ndaj personave që do të pengojnë zbatimin e këtij titulli ekzekutiv në kundërshtim me parashikimet e ligjit, përbaruesi gjyqësor ka të drejtë të aplikojë sanksionet e parashikuara në nenet 598 dhe 606 të Kodit të Procedurës Civile si dhe të ndërmarrë çdo sanksion tjetër të parashikuar nga ligji.

5. Ky urdhër i njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile kanë të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni.

**Shoqëria “Tirana Execution Office” (TEO) SHPK
Përbarues Gjyqësor Privat
Fatjona Duka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË

NR. 1026 (31134-03458-80) RREGJ.
DATA Rregj 01.06.2018

Nr.1026 Vendimi
Date 05.06.2018

VENDIM

“Leshim urdher ekzekutimi”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tirane, e përbërë prej:

Erarber MADHI – Gjyqtar

asistuar nga sekretare gjyqësore Gersiana Skifteri, sot në datë **05.06.2018**, mori në shqyrtim në Dhomë Keshillimi, ceshtjen administrative me nr.**1026** akti, që i perket:

Kerkues: Autoriteti i Mediave Audiovizive. **Ne mungese.**

Objekti: Leshim i Urdherit të Ekzekutimit për sanksionin me gjobe nr.73 , date 02.08.2017 të Grupit të Inspektimit të AMA-s, të vendosur ndaj personit fizik Fredi Hasa për subjektin OSHMA “TV me kabell Pirg” lene në fuqi me vendimin Nr 178 date 04.09.2017 të AMA

Baza ligjore: Neni 511, germa "g" i Kodit të Procedurës Civile. Ligji nr. 49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", i ndryshuar.

Gjykata, pasi shqyrtoi ceshtjen në teresi, si administroi provat shkresore, në mungese të pales kerkuese,

VEREN

Se kerkuesi, **Autoriteti i Mediave Audiovizive**, me kerkesen drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, kerkon: *“Leshim i Urdherit të Ekzekutimit për sanksionin me gjobe nr.73 , date 02.08.2017 të Grupit të Inspektimit të AMA-s, të vendosur ndaj personit fizik Fredi Hasa, për subjektin*

OSHMA " "TV me kabell Pirg" lene ne fuqi me vendimin Nr 178 date 04.09.2017 te AMA-s."



Ne aktin administrativ ne trajten e gjobes, eshte vendosur "per denimin me gjobe ndaj personit fizik Fredi Hasa per subjektin OSHMA " "TV me kabell Pirg", ne shumen 1.000.000 (nje milion) leke.

Sipas nenit 133/13, te ligjit nr. 97/2013 "Per mediat audiovizive ne Republiken e Shqiperise" dhe ligjit nr. 10279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative", ne lidhje me nenin 510, germa "a", te Kodit te Procedures Civile, eshte percaktuar se tituj ekzekutiv, jane edhe vendimet per kundervajtjet administrative, te leshuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, Tirane, qe kane marre forme te prere.

Meqenese akti administrativ, ne trajten e gjobes nr.73 , date 02.08.2017 te Grupit te Inspektimit te AMA-s, te vendosur ndaj personit fizik Fredi Hasa per subjektin OSHMA " "TV me kabell Pirg" lene ne fuqi me vendimin Nr 178 date 04.09.2017 te AMA-s." , ka marre forme te prere, pasi eshte ankimuar ne gjykate dhe me ane te Vendimit Nr 1613 date 30.04.2018 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane ka vendosur rrezimin e padise se paditesit Fredi Hasa.

Ne keto kushte Vendimi per denimin me gjobe nr.73 , date 02.08.2017 te Grupit te Inspektimit te AMA-s, te vendosur ndaj personit fizik Fredi Hasa per subjektin OSHMA " "TV me kabell Pirg" lene ne fuqi me vendimin Nr 178 date 04.09.2017 te AMA-s." perben titull ekzekutiv dhe kerkesa per leshimin e urdherit te ekzekutimit, konform nenit 511/a, te Kodit te Procedures Civile, duhet pranuar, si e bazuar ne prova dhe ne ligj.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 510/a e 511/a te K.Pr.Civile

VENDOSI



- Pranimin e kerkeses .

-Leshimin e Urdherit te Ekzekutimit per Aktin administrativ ne trajten e gjobes Nr . 73 , date 02.08.2017 te Autoritetit te Mediave Audiovizive lene ne fuqi me vendimin nr 178 date 04.09.2017 te AMA-s per denimin me gjobe te subjektit person fizik Fredi Hasa per subjektin OSHMA "TV me Kabell Pirg " ne shumen 1.000.000 (nje milion) leke .

-Urdherohen Zyra e Permbarimit ne Republiken e Shqiperise per ekzekutimin e ketij vendimi.



vendim leshohet nje kopje dhe si i tille ka vlere.


U shpall ne Tirane me date 05.06.2018

Sekretare

Gersiana Skifteri

Gjyqtar

Erarber Madhi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 7 DATE 2 / 8 / 2017

PËR


DËNIMIN ME GJOBË SUBJEKTIT PERSON FIZIK Z. FREDI HASA,
AUTORIZUAR PËR SUBJEKTIN OFRUES TË SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIOVIZIV
(OSHMA) "TV ME KABËLL PIRG"

Grupi i inspektorëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në zbatim të Urdhrit Nr. 75, datë 21.07.2017 të Kryetarit të AMA-s "Për inspektimin e veprimtarisë audiovizive të subjekteve (OSHMA), si dhe inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarive të palicencuara/paautorizuara nga subjekte të tjerë", në datën 26.07.2017, ka tentuar të kryejë kontrollin e veprimtarisë audiovizive të subjektit person fizik z. Fredi Hasa, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë sipas legjislacionit përkatës në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse të subjektit OSHMA "TV me kabëll Pirg".

Grupi i inspektimit u paraqit në adresën ku subjekti person fizik z. Fredi Hasa ka të instaluar pajisjet audiovizive transmetuese të subjektit "TV me kabëll Pirg". Në prezencë të përfaqësuesit të subjektit z. Zylfer Hasa, si dhe pas njohjes së tij me urdhrin e inspektimit, grupi i inspektimit tentoi të kryejë kontrollin në studion e transmetimit. Përfaqësuesi i subjektit nuk mundësoi grupit të inspektimit kryerjen e kontrollit. Në këto kushte u kontaktua me z. Besnik Hasa në cilësinë e administratorit të subjektit por ky i fundit, edhe pse u përsëri njoh me urdhrin dhe qëllimin e tij, nuk pranoi ushtrimin e kontrollit duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv", miratuar me Vendimin Nr. 101 datë 07.06.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Në Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve", miratuar me Vendim Nr. 56 datë 10.07.2015 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, neni 12, pika 1/c, parashikohet se:

Subjekti që pajiset me autorizim për ofrimin e njërit apo më shumë shërbimeve të parashikuara në këtë rregullore është i detyruar që:



Të garantojë prezencën e të paktën një punonjësi ose të një personi të autorizuar prej tij, në çdo kohë (24 orë në ditë, për 7 ditë të javës), në vendin/ambientin ku janë të vendosura pajisjet audiovizive dhe në çdo ambient ku emetohet sinjali i transmetimit audio dhe/ose audioviziv, si dhe të lejojë inspektimin e tyre nga inspektorët e AMA-s, në bazë të rregullores përkatëse të AMA-s "Mbi procedurat e inspektimit dhe monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv".

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se subjekti nuk ka lejuar hyrjen e inspektorëve në ambientet ku subjekti ka të instaluar pajisjet audiovizive transmetuese të ofruesit të shërbimeve mediatika audiovizive (OSHMA) "Tv me kabëll Pirg".

Në nenin 78 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar, parashikohet se:

4. I licencuari dhe/ose i autorizuari duhet t'i paraqesë personit të autorizuar për kryerjen e inspektimit informacionin apo regjistrimet që zotëron lidhur me këtë kontroll, të lejojë hyrjen në mjediset e veta për të realizuar inspektimin dhe të ushtrojë këqyrjen e pajisjeve transmetuese në këto mjedise, si dhe, kur është e nevojshme, t'u përgjigjet kërkesave të personit të autorizuar për ushtrimin e inspektimit me qëllim realizimin e tij.

Neni 133, pika 2/dh të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se:

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga i licencuari ose i autorizuari, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

2. Me gjobë nga 120 000 deri në 2 000 000 lekë për rastet kur:

dh) ndalon hyrjen e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet audiovizive të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara prej tyre;

Në respektim edhe të kërkesave ligjore të nenit 18 të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", si dhe nenit 132, pika 1, paragrafi i fundit të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, grupi i inspektorëve, në përcaktimin e masës së dënimit, mban parasysh faktin se ndalimi i hyrjes së inspektorëve në mjediset ku subjekti ka të vendosura pajisjet audiovizive është kryer me dashje dhe me qëllim për të fshehur shkeljet e të drejtave të transmetimit, që subjekt ishte duke kryer në çastin kur inspektorët kanë kërkuar zbatimin e urdhrin nr. 75 datë 26.07.2017 të Kryetarit të AMA-s për të ushtruar kontrollin e veprimtarisë audiovizive të subjektit.

Për gjithë sa më sipër, në mbështetje të nenit 78/4, nenit 132/1/a, nenit 133, pika 2/dh të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Rregullores "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv", miratuar me Vendimin Nr. 101 datë 07.06.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, grupi i inspektorëve të AMA-s,



VENDOSI:

1. Të ndëshkojë me sanksion gjobë në masën 1.000.000 (një milion) lekë subjektin person fizik z. Fredi Hasa, të autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Pirg".
2. Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve në adresën: (a) *Raiffeisen Bank, Nr. Llog. 0100007029*; (b) *BKT Nr. 402947044*. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 për qind në muaj të masës së gjobës.
3. Gjoba është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në AMA brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni.

~~Ky vendim hyn në fuqi menjëherë~~

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES
GRUPI I INSPEKTORËVE

Klodian KANANI



Tonin PRENGA



Endrit ÇAMI

